



Procedurat e pranimit dhe të regjistrimit të kandidatëve që aplikojnë për transferim të studimeve dhe për program të dytë studimi, në programet e ciklit të dytë të studimeve, në institucionet e arsimit të lartë

Viti Akademik 2022-2023 / Kreu IV/5		Afatet e përfundimit dhe datat e realizimit
1.	Kreu IV/5, pika 1 Kandidatët që kërkojnë të ndjekin një program të dytë studimi apo të transferojnë studimet në programet e ciklit të dytë të studimeve kanë të drejtë të aplikojnë pranë IAL-ve, në datat e përcaktuara, për çdo vit akademik..	Deri më 04.11.2022
2.	Kreu IV/5, pika 18 IAL-ja shpall listat e kandidatëve që kanë aplikuar për transferim studimesh dhe ato të kandidatëve që kanë aplikuar për program të dytë studimi në vende të dukshme brenda datës së përcaktuar.	06.11.2022
3.	Kreu IV/5, pika 19, Paragrafi 1 Aplikimet për transferimin e studimeve dhe program të dytë studimi shqyrtohen nga komisioni/komisionet i/e ngritur/a për këtë qëllim nga IAL-ja brenda datës së përcaktuar. Komisionet kryejnë vlerësimin e dosjeve në zbatim të kuadrit ligjor e nënligjor në fuqi, si dhe të kriterëve të tjera të shpallura para hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, bazuar në pikëzimin për çdo kriter vlerësimi, e cila shpallet nga dekani përkatës në mjediset e fakultetit të IAL-së, si dhe faqet elektronike zyrtare përkatëse (web), e plotësuar sipas tabelave 1a dhe 1b, të shtojcës nr.8 të këtij udhëzimi.	10.11.2022
4.	Kreu IV/5, pika 19, Paragrafi 2 IAL-të, për çdo program studimi që ofrojmë, publikojnë listat me renditjen e kandidatëve brenda datës së përcaktuar. Në listën e publikuar nga ana e IAL-ve, fituesi i fundit përcaktohet me vijë të kuqe, në varësi të kuotave të ofruara për programin përkatës të studimit. Në këtë listë bëhen me dije pikët vlerësuese për çdo kriter vlerësimi.	11.11.2022
5.	Kreu IV/5, pika 21 IAL-të shpallin listat përfundimtare me renditjen e kandidatëve, në faqet elektronike zyrtare dhe në mjediset e tyre, brenda datës së përcaktuar.	13.11.2022
6.	Kreu IV/5, pika 22, fjalia 1 Regjistrimi i kandidatisit i cili mund të paraqitet personalisht ose nëpërmjet personit të autorizuar prej tij, kryhet pranë sekretarive mësimore sipas kalendarit të miratuar, për çdo vit akademik.	14.11.2022 – 18.11.2022
7.	Kreu IV/5, pika 22, fjalia 2 Kuotat e paplotësuara plotësohen me kandidatët e renditur sipas pikëve të fituara mbas vijës së kuqe, brenda datës së përcaktuar.	19.11.2022
8.	Kreu IV/5, pika 23 IAL-të brenda datës së përcaktuar, dërgojnë pranë QSHA-së, listën e studentëve të regjistruar, në formë shkresore dhe elektronike në format Excel me qëllim pajisjen me numër matrikullimi, sipas programit të studimit dhe tipologjisë së kandidatisit. IAL-të nuk duhet të dërgojnë në QSHA të dhënat e asnjë kandidati pas kësaj date. Për të gjithë emrat kandidatë të dërguar pas kësaj date ose që nuk plotësojnë kriteret e parashikuara në legjislacionin në fuqi, nuk do të procedohet me dhënie të numrave të matrikullimit dhe QSHA-ja duhet të kërkojë nga IAL-ja, duke njoftuar edhe kandidatin, çregjistrimin e tyre dhe konfirmimin me shkresë zyrtare brenda një afati 10 ditor për kryerjen e procesit të çregjistrimit të kandidatisit nga IAL.	21.12.2022